



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 14.05.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 9.1,10 dhe 13.g të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, dhe Përfundimin 01 Nr. 06-31800-15/1 të mbajtur në Mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt. 07.05.2015 për mbulimin e shpenzimeve të OJQ “ProCult, me dt: 14.05.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e OJQ “ProCult” – për projekt buxhetin për Zyra Informativ Turistike 2015 nr.06-400-32429 e dt: 12.05.2015 për mbulimin e shpenzimeve operative dhe për mbarëvajtjen e punës ,duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 5.849,00€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 5.849,00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë të OJQ “ProCult” nr. 1402000001783668 Banka Ekonomike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- OJQ “ProCult” rr. “Hadum Aga” p.n. Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila